



Në mbështetje të nenit 64.2 pika (a) dhe (b), neneve 96, 97 dhe 98 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP) dhe nenit 15 të Ligjit nr. 03/L-256 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe neneve 20, 24 dhe 29.2 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (LZL), Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datën 09.03.2023, miraton këtë:

RREGULLORE NR. 06/2023 REGJISTRIMI DHE VOTIMI JASHTË KOSOVËS

Neni 1 Fushëveprimi

Kjo Rregullore përcakton mënyrën e regjistrimit për të votuar nga jashtë Kosovës, pranimin e fletëvotimit, mënyrën e votimit dhe numërimin e fletëvotimeve të pranuar nga jashtë Kosovës.

Neni 2 Regjistrimi për të votuar jashtë Kosovës

1. Votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund të votojë për zgjedhjet në bazë të procedurave që përcaktohen me këtë Rregullore, nëse ai ose ajo:
 - 1.1. Është regjistruar si banor i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil;
 - 1.2. për zgjedhjet e fundit në Kosovë është regjistruar si votues për votim jashtë Kosovës dhe në atë kohë kishte demonstruar se ka zotësi juridike si votues, në bazë të kriterëve të përcaktuara ligjore.
2. Dy kategoritë e lartcekura mund të aplikojnë për të pranuar fletëvotimin/et për votim jashtë Kosovës, duke e dorëzuar të plotësuar Formularin për aplikim I - shtojca I dhe një dokument identifikimi me fotografi që e dëshmon shtetësinë e Republikës së Kosovës për kategorinë në paragrafin 1 dhe nënparagrafin 1.1. të këtij neni, si dhe një dokument identifikimi me fotografi, të vendit ku jeton për kategorinë në paragrafin 1 nënparagrafin 1.2. të këtij neni.
3. Personi i cili ka për qëllim ta hedhë votën për votim jashtë Kosovës, i cili nuk i plotëson kriteret e parashtruara në paragrafin 1 të këtij neni, do të regjistrohet në KQZ si votues jashtë Kosovës duke dorëzuar:

- 3.1. Formularin për aplikim/regjistrim për votim jashtë Kosovës, - Formularin për aplikim II - shtojca II;
- 3.2. dëshminë e dokumentuar të identitetit dhe që ai ose ajo i plotëson kriteret ligjore për të drejtën për të votuar në pajtim me nenin 5 të LZP dhe të bashkëngjiten dokumentet e fotokopjuara, siç janë të renditura në Procedurën për vlerësimin e kriterëve të zotësisë juridike - shtojcën III.
4. Votuesi me të drejtë vote mund të aplikojë për të marrë një fletëvotim për votim jashtë Kosovës, duke dorëzuar të plotësuar dhe nënshkruar formularin për regjistrim/aplikim sipas njëres nga mënyrat, si në vijim:
 - 4.1. Nëpërmjet postës, në një nga kutitë postare të KQZ;
 - 4.2. Nëpërmjet faksit të KQZ, në numrin e shënuar në fund të formularit për regjistrim/aplikim për votim jashtë Kosovës;
 - 4.3. nëpërmjet platformës online të aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës.
5. Formulari i plotësuar për regjistrim/aplikim dhe kopjet e dokumenteve duhet të dërgohen në KQZ, në mes të periudhës kohore 25 ditë pas ditës së shpalljes së zgjedhjeve dhe 60 ditë para ditës së zgjedhjeve. Afati i aplikimit për regjistrim në ditën e gjashtëdhjetë, përfundon në orën 16:00, sipas kohës lokale në Republikën e Kosovës.
6. KQZ shqyrton kërkesat për regjistrim/aplikim të votuesve jashtë Kosovës, deri në afatin përfundimtar të përcaktuar në paragrafi 5 të këtij neni:
 - 6.1. Pranon kërkesën dhe ia dërgon parashtruesit të kërkesës fletëvotimin me postë në adresën e saktësuar në formularin e regjistrimit/aplikimit, apo përmes e-mailit në adresën elektronike që e ka dhënë në periudhën e aplikimit për regjistrim;
 - 6.2. refuzon kërkesën dhe njofton parashtruesin e kërkesës me shkrim për arsyet e këtij vendimi dhe këshillën juridike se ai/ajo mund të kërkojë korrigjim ligjor te organet kompetente, në pajtim me LZP. Nëse organi kompetent vendos që votuesi ka të drejtë të merr pjesë në programin e votimit jashtë Kosovës, e urdhëron KQZ ta përfshijë votuesin.
7. Personi të cilit i është refuzuar regjistrimi si votues jashtë Kosovë, siç është përcaktuar në paragrafin 6 nënparagrafi 6.2. të këtij neni, mund të vendosë të bëjë korrigjimin ose të plotësojë formularin për regjistrim/aplikacionin dhe ta paraqesë përsëri në KQZ formularin për regjistrim/aplikim, deri në afatin përfundimtar të përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni.

8. Pas mbylljes së afatit për aplikim/ regjistrim për votim jashtë Kosovës, aplikuesit të cilit i është refuzuar kërkesa për regjistrim, ka të drejtë ankese në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, 24 orë prej momentit të marrjes së njoftimit për refuzim të kërkesës për regjistrim.
9. KQZ duhet ta përpilojë listën e votuesve jashtë Kosovës, e cila përmban të dhënat e atyre votuesve që me sukses janë regjistruar për votim jashtë Kosovës dhe t'i largojë emrat e tyre nga Listat e Votuesve – LV që përdoret në vendvotime –VV në Kosovë. Votuesit e regjistruar në listën e votuesve jashtë Kosovës informohen se hiqen nga LV në VV brenda Kosovës.
10. Lista e votuesve jashtë Kosovës, publikohet në ueb-faqen e KQZ, në ditën kur fillon periudha e kundërshtimit dhe konfirmimit e LV. Lista e votuesve jashtë Kosovës do të përmbajë këto të dhëna: numrin e regjistrimit si votues jashtë Kosovës, mbiemrin, emrin, vitin e lindjes, komunën ku votuesi ka vendbanimin në Kosovë dhe emrin e shtetit ku jeton.

Neni 3

Mënyra e votimit

1. Votuesi me zotësi juridike i cili është regjistruar me sukses si votues jashtë Kosovës, mund ta marrë fletëvotimin nëpërmjet njëres nga mënyrat, si më poshtë:
 - 1.1. Duke pranuar fletëvotimin(et) në adresë ekzistuese jashtë Kosovës, të cilën ajo/ ai e jep për këtë qëllim, ose duke ia dërguar përmes e-mailit, në adresën elektronike, të cilën e ka dhënë gjatë periudhës së aplikimit për regjistrim;
 - 1.2. duke marrë personalisht fletëvotim(et) në njërin nga misionet diplomatike të Kosovës;
 - 1.3. të shkarkojë fletëvotimin nga ueb faqja e KQZ në internet.
2. Pas plotësimit të fletëvotimit(ëve), duhet të vendosë fletëvotimin(et) në një zarf të pashënuar e të mbyllur, të vendosur brenda zarfit të jashtëm/për dërgim (pako). Në zarfin e jashtëm/për dërgim votuesi gjithashtu vendosë një fotokopje të dokumentit të tij/saj të vlefshëm të identifikimit dhe një shënim që përmban të dhënat personale të tij/saj dhe që përmban së paku emrin, mbiemrin, emrin e babait dhe datën e lindjes së tij /saj.
3. Pas plotësimit të fletëvotimit për votim jashtë Kosovës, votuesi duhet ta dërgojë atë me postë në njërin nga kutitë postare që hapen dhe shpallen publikisht nga KQZ, deri në datën që përcaktohet nga KQZ.
4. Votat jashtë Kosovës duhet të pranohet nga KQZ një ditë para ditës së zgjedhjeve, më së voni deri në momentin e mbylljes së VV në Kosovë, orën 19.00.

- 4.1. Pakoja me fletëvotime duhet të përmbajë pullën dhe vulën postare të shtetit ku votuesi jeton;
- 4.2. Pakoja me fletëvotim që dërgohet përmes postave të shpejta, do të merren nga KQZ, nën përcjelljen e Policisë së Republikës së Kosovës;
 - 4.2.1. Pakoja me fletëvotime duhet të përmbajë vetëm një fletëvotim.

Neni 4

Numërimi i fletëvotimeve për votim jashtë Kosovës

1. KQZ do ta konsiderojë të pavlefshme dhe nuk do ta numërojë fletëvotimin që është dërguar nga votimi jashtë Kosovës, bazuar në kriteret si në vijim:
 - 1.1. Nga personi i cili nuk është votues me zotësi juridike ose të cilit i është refuzuar formulari për regjistrim/aplikim për votim jashtë Kosovës me vendim të KQZ, i cili nuk është hedhë poshtë nga ndonjë organ kompetent në pajtim me LZP;
 - 1.2. nga personi, i cili nuk ka aplikuar gjatë periudhës së aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës;
 - 1.3. në bazë të vendimit të organit kompetent në pajtim me LZP për refuzimin e kërkesës së votuesit jashtë Kosovës;
 - 1.4. nga personi, identiteti i të cilit nuk mund të përcaktohet;
 - 1.5. nëse Formulari i plotësuar për regjistrim/aplikim dhe kopjet e dokumenteve janë dërguar pas afatit përfundimtar të parashtruar në nenin 2 paragrafi 5 të kësaj Rregulloreje.
2. Njësia e votimit jashtë Kosovës e KQZ do t'i dorëzojë zarfet e fshehtësisë të konfirmuara me shënimet për identifikim të bashkangjitura dhe të klasifikuara në bazë të komunave, në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR).

Neni 5

Raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetar

Personi me zotësi juridike që dëshiron të votojë jashtë Kosovës për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, mund të votojë duke marrë fletëvotimin, siç parashihet në nenin 3 paragrafi 1 të kësaj Rregulloreje.

Neni 6
Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregulla Zgjedhore Nr.03/2013 votimi jashtë Kosovës.
2. KQZ do të hartojë procedurë të veçantë për votimin jashtë Kosovës, në të cilën do të përshkruhen hapat për mënyrën e aplikimit për regjistrim, për mënyrën e verifikimit dhe vlerësimit të aplikacioneve për regjistrim, për mënyrën e votimit përmes postës dhe për mënyrën e vlerësimit të pakove me fletëvotime.
3. Pjesë përbërëse të kësaj Rregullore janë shtojcat:

shtojca I – Formulari për aplikim I

shtojca II- Formulari për aplikim II

shtojcën III-Procedura për vlerësimin e kritereve të zotësisë juridike

Neni 7
Hyrja ne Fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga KQZ.

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi